

Vendim nr. 180 datë 10.07.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 10.07.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 31 (A) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ADIL NEZIRAJ

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 344, datë 02.02.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 1591, datë 13.04.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-3408 (348) datë 10.09.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 141 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 1 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; neni 1 i Protokollit Shtesë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 71, 71/a, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi, me shkresën e datës 25.02.2013, është emëruar përgjegjës i sektorit të hartografimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (*DPSHGJSH*) e, në vijim, me shkresën e datës 22.04.2013 të drejtorit të përgjithshëm të DPSHGJSH-së është transferuar në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (*METE*), ndërsa me shkresën e datës 16.09.2013 të drejtorit të përgjithshëm të DPSHGJSH-së është emëruar në pozicionin e drejtorit të drejtorisë së Gjeologjisë Inxhinierike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë (*DGJIGJGJ*), detyrë të cilën e ka ushtruar deri në datën 14.10.2013.

2. Në vijim, me shkresën nr.1365 prot., datë 14.10.2013 të drejtorit të përgjithshëm të DPSHGJSH-së, me objekt “Emërime dhe transferime në detyrë”, kërkuesi është larguar nga detyra e drejtorit të DGJIGJGJ-së, me arsyetimin se ishte jashtë profilit të vendit të punës dhe është emëruar në pozicionin “specialist”. Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr.1191/8, datë 14.08.2014 “Akti i deklarimit të statusit të punësimit” i ka dhënë kërkuesit statusin e nëpunësit civil në pozicionin “specialist” në sektorin e hartografimit në Drejtorinë e Gjeologjisë, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (*SHGJSH*).

3. Në datën 03.11.2014 kërkuesi i është drejtuar gjykatës me padi, duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ nr.1365 prot., datë 14.10.2013 të drejtorit të përgjithshëm të DPSHGJSH-së, kthimin e tij në detyrën e mëparshëm ose të një niveli të barasvlershëm me të, si dhe pagimin e diferencës së pagës për të gjithë periudhën e kohës, nga zbritja në detyrë deri në kthimin në detyrën e mëparshme ose në një pozicion të barasvlershëm me të.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 344, datë 02.02.2015, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në ligj dhe në prova. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.1591, datë 13.04.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, por me arsyetim

të ndryshuar. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3408 (348), datë 10.09.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit për rrëzimin e padisë së kërkuetit.

5. Në datën 29.05.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr.8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuetit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmblëdhur, ka pretenduar se vendimi i kundërshtuar i ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

6.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi gjykatat e zakonshme kanë zhvilluar një gjykim formal në për zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjes mes palëve, duke dhënë vendime që kanë sjellë pasoja të drejtpërdrejta, negative dhe reale për kërkuetin.

6.2. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk i ka dhënë përgjigje përfundimtare kërtimeve të ngritura në rekurs për identifikimin e ligjit material të zbatueshëm në momentin e nxjerrjes së aktit administrativ 1365 prot., datë 14.10.2013. Kolegji Administrativ nuk ka bërë një vlerësim të drejtë dhe objektiv në kushtet kur vendimet e gjykatave më të ulëta kanë dhënë zgjidhje ligjore me arsytetime të ndryshme. Ligji i zbatueshëm në kohën e nxjerrjes së aktit administrativ 1365 prot., datë 14.10.2013, ka qenë ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (*ligji nr.152/2013*). Arsyetimi i Kolegjit Administrativ është alogjik, për shkak se edhe pse konkludon se në rastin e kërkuetit ligji i zbatueshëm është Kodi i Punës dhe jo ligji nr.152/2013, ndërkohë u referohet afateve ligjore për ngritjen e padisë, duke pretenduar se kërkuesi nuk ka treguar dilijencën e duhur për kundërshtimin e aktit administrativ 1365 prot., datë 14.10.2013, në kohën e lindjes së

konfliktit, për të përfituar nga efektet prapavepruese të vendimit nr. 5, datë 05.02.2014 të Gjykatës.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuarit

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kritere paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht, për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

8. Kolegji vlerëson se kërkuari, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet gjyqësore të kundërshtuara prej tij, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuari i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

10. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Për llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual Gjykata ka theksuar se kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se vendimi i më i fundit kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë mban datën 10.09.2024, ndërkohë që ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 29.05.2025. Referuar akteve bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, rezulton se vendimi i Gjykatës së Lartë i është njoftuar kërkuesit në adresën elektronike në datën 20.02.2025. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, ndaj kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*.

12. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, të cilat *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues, ndaj Kolegji vlerëson t’i analizojë të ndërthurura me njëra-tjetrën.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

13. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e zakonshme kanë zhvilluar një gjykim formal për zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjes mes palëve, duke dhënë vendime, të cilat kanë sjellë pasojë të drejtpërdrejta, negative dhe reale për kërkuesin. Po kështu, sipas kërkuesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk i ka dhënë përgjigje përfundimtare kërkimeve të ngritura në rekurs për identifikimin e ligjit material të zbatueshëm në momentin e nxjerrjes së aktit administrativ 1365 prot., datë 14.10.2013. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Administrativ nuk ka bërë një vlerësim të drejtë dhe objektiv në kushtet kur vendimet e gjykatave më të ulëta kanë dhënë zgjidhje ligjore me arsyeime të ndryshme. Sipas kërkuesit, ligji i zbatueshëm në kohën e nxjerrjes së aktit administrativ 1365 prot., datë 14.10.2013, ka qenë ligji nr.152/2013. Po kështu,

sipas kërkuessit, arsyetimi i Kolegjit Administrativ është alogjik për shkak se, edhe pse konkludon se në rastin e tij ligji i zbatueshëm është Kodi i Punës dhe jo ligji nr.152/2013, ndërkohë u referohet afateve ligjore për ngritjen e padisë, duke pretenduar se kërkuessi nuk ka treguar diligjencën e duhur për kundërshtimin e aktit administrativ 1365 prot., datë 14.10.2013, në kohën e lindjes së konfliktit, për të përfituar nga efektet prapavepruese të vendimit nr. 5, datë 05.02.2014 të Gjykatës.

14. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka pohuar se neni 42 i Kushtetutës sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 31, datë 3.11.2022; nr. 56, datë 25.07.2017 dhe nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, përpara së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 12, datë 24.05.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr.76, datë 22.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në lidhje me standardin e arsytimit, Gjykata është shprehur se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për vendim gjyqësor të arsyetuar, që garantohet nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i drejtësisë së vendimeve. Gjykata ka pohuar se standardi i arsytimit është i lidhur edhe me respektimin e të drejtave të tjera kushtetuese, siç është e drejta e aksesit në gjykim dhe e drejta e ankimit efektiv. (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr.45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë,

dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Megjithatë, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr.45, datë 03.07.2017; nr.12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata në mënyrë konstante në jurisprudencën e saj ka pohuar se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi dhe zbatimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes. Ajo nuk mund të bëjë vlerësim të provave, interpretim të ligjit dhe as të përcaktojë mënyrën e zgjidhjes së çështjes, sepse këto të fundit hyjnë në sferën e kompetencave të gjykatave të sistemit gjyqësor (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 7, datë 07.02.2017; nr. 13, datë 10.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Duke iu rikthyer çështjes në shqyrtim, referuar praktikës dokumentare të paraqitur nga kërkuuesi, Kolegji vëren se procesi gjyqësor është vënë në lëvizje mbi një padi të kërkuarit, nëpërmjet së cilës është kërkuar konstatimi i pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ nr.1365 prot., datë 14.10.2013 të drejtorit të përgjithshëm të DPSHGJSH-së, kthimi i kërkuarit në detyrë, në pozicionin e mëparshëm ose në një pozicion tjetër të të njëjtit nivel ose të barasvlershëm me të, si dhe pagimi i diferencës së pagës për gjithë periudhën e kohës, nga zbritja në detyrë deri në kthimin në detyrë e mëparshme ose pozicion tjetër të të njëjtit nivel të barasvlershëm me të. Në përfundim të gjykimit, gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në ligj dhe në prova, me arsyetimin se kohëzgjatja në detyrë e drejtorit të DGJIGJGJ-së ka qenë vetëm një muaj, ndërkohë sipas nenit 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, si dhe Kreut III, të VKM nr.116, datë 05.03.2014 “Për statusin e nëpunësve civilë dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësve civilë sipas ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” (VKM nr.116/2014), punonjësi duhet të ketë qenë i punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se një vit, për të përfituar statusin e nëpunësit civil, për shkak të ligjit. Sipas gjykatës

së shkallës së parë, në momentin e kryerjes së veprimit administrativ nga pala e paditur, largimit nga detyra të kërkuesit dhe emërimin e tij në një detyrë më të ulët brenda institucionit, kërkuesi nuk e ka gëzuar statusin e nëpunësit civil, për rrjedhojë ligji i zbatueshëm në çështjen e tij nuk është ligji nr.152/2013, por ai nr.7961, datë 12.07.1995, Kodi i Punës. Po kështu, ajo gjykatë në arsyetimin e saj ka theksuar se edhe pse me VKM-në nr.5, datë 30.09.2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” (VKM-ja nr.5/2013), janë shtyrë efektet juridike të ligjit nr.152/2013 me 6 muaj pas hyrjes së tij në fuqi në datën 01.10.2013, Gjykata, me vendimin nr.5, datë 05.02.2014, ka vendosur shfuqizimin e VKM-së nr.5/2013, si të papajtueshme me Kushtetutën, vendim që ka hyrë në fuqi në datën 26.02.2014. Në vijim të arsyetimit të saj, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se sipas pikës 2, shkronja “b”, të nenit 76 të ligjit nr.8577/2000 vendimi i Gjykatës në rastin konkret nuk ka fuqi prapavepruese, duke qenë se në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, që është data e botimit në Fletoren Zyrtare, në datën 26.02.2014, çështja gjyqësore e kërkuesit nuk ka qenë në gjykim.

18. Në vijim, për ankimin e kërkuesit, gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, por me arsyetim të ndryshuar. Sipas gjykatës së apelit, ligji nr.152/ 2013 ka hyrë në fuqi në datën 01.10.2013, pra rrjedhimisht edhe situata faktike juridike rregullohet nga dispozitat ligjore të këtij ligji, ndonëse VKM-ja nr.5/2013, i shtyu me 6 muaj efektet e këtij rregullimi ligjor, si rezultat i hyrjes në fuqi dhe miratimit me ligj të këtij akti normativ. Sipas gjykatës së apelit, shfuqizimi i këtij të fundit dhe i ligjit përkatës që e ka miratuar atë si të papajtueshëm me Kushtetutën nga Gjykata, ka sjellë si pasojë që efektet e ligjit nr. 152/ 2013 të nisin që nga data e hyrjes në fuqi të tij, pra *ex tunc*, për shkak se arsyeja e shtyrjes së efekteve të tij nuk ekzistonte më. Ndërkohë, sipas asaj gjykate, në datën 14.10.2013, kur kërkuesi është larguar nga detyra e drejtorit të përgjithshëm të DPSHGJSH-së, ai nuk gëzonte statusin e nëpunësit civil, pasi kohëzgjatja në këtë detyrë ka qenë vetëm 1 muaj, ndërkohë, sipas nenit 67, pika 3, të ligjit nr. 152/ 2013, si dhe Kreut III të VKM-së nr. 116/2014, punonjësi duhet të këtë qenë i punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, për të përfituar statusin e nëpunësit civil, për shkak të ligjit, si dhe në rastin e kërkuesit nuk ka një akt konfirmimi të statusit të nëpunësit civil nga organi administrativ kompetent. Sipas gjykatës së apelit, konfirmimi i statusit të nëpunësit civil për kërkuesin është bërë me aktin nr. 1191/8, datë 14.08.2014 (pra pasi ai ishte larguar nga detyra e drejtorit) dhe është konfirmuar si nëpunës civil

në pozicionin e specialistit të sektorit të Hartografisë në Drejtorinë e Gjeologjisë së SHGJSH-së dhe jo në pozicionin e drejtorit.

19. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit me arsyetimin se pretendimi i kërkuesit për zbatimin e ligjit nr. 152/ 2013 që nga data 01.10.2013, pretendim ky i pranuar nga Gjykata Administrative e Apelit, është në një linjë interpretimi të gabuar të ligjit procedural dhe material dhe në kundërshtim me praktikën e qëndrueshme të Kolegjit Administrativ për ligjin e aplikueshëm në këto raste. Në këto kushte, sipas Kolegjit Administrativ, Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka zgjidhur mosmarrëveshjen objekt gjykimi në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të detyrueshme për zbatim, të cilat çojnë në të njëjtën zgjidhje me atë të vendimit të rekursuar. Sipas Kolegjit Administrativ, ligji që ka rregulluar marrëdhënien mes palëve, në çështjen objekt shqyrtimi, nuk është ligji nr. 152/ 2013, por Kodi i Punës, për shkak se kërkuesi nuk e gëzonte statusin e nëpunësit civil. Sipas Kolegjit Administrativ, në ndryshim nga sa ka vlerësuar Gjykata Administrative e Apelit, kërkuesi nuk ka gëzuar statusin e nëpunësit civil si drejtor, jo për faktin se nuk ka plotësuar 1 vit në këtë funksion dhe ky status nuk i është konfirmuar nga njësia përgjegjëse sipas nenit 67 të ligjit nr. 152/ 2013, por për shkak se në kohën kur është vendosur transferimi i tij nga detyra e drejtorit në atë të specialistit, në rastin e kërkuesit nuk aplikohet ligji nr.152/ 2013. Sipas Kolegjit Administrativ, Gjykata e Lartë, në mënyrë konsistente, ka mbajtur qëndrimin se vendimi nr.5, datë 05.02.2014 i Gjykatës do të zbatohet me efekt prapaveprues në raport me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/ 2013, vetëm në çështjet që kanë qenë të regjistruara në gjykatë përpara se të botohej ai vendim, i cili shfuqizonte aktin normativ, VKM-në nr.5/2013, që shtynte hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/ 2013. Kolegji Administrativ ka arsyetuar se akti administrativ nr. 1365 prot., datë 14.10.2013 i DPSHGJSH-së nuk ka dalë në zbatim të ligjit nr. 152/ 2013, por në zbatim të Kodit të Punës, i cili rregullonte marrëdhënien mes palëve në këtë datë, si dhe ky akt nuk është kundërshtuar gjyqësisht nga pala paditëse (kërkuesi) në kohën e lindjes së konfliktit, ndërkohë që padia rezulton të jetë depozituar në gjykatë në datën 03.11.2014, pra pas afro 9 muajsh pas dhënies së vendimit nr. 5, datë 05.02.2014 të Gjykatës, për pasojë ky vendim nuk i shtrin efektet prapavepruese në rastin konkret. Sipas Kolegjit Administrativ, mbështetur në Kodin e Punës, si ligji që rregullonte marrëdhënien mes palëve në kohën e lindjes së konfliktit, vendimi për transferimin e paditësit nuk paraqet shkaqe të pavlefshmërisë absolute dhe as pasoja e kërkuar nuk gjen mbështetje.

20. Për sa më sipër, bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, si dhe referuar vendimeve gjyqësore, vërehet se kërkuesi ka ushtruar lirisht të drejtën e ngritjes së padisë, sikurse edhe të drejtën e ankimit/rekursit dhe përmes një procesi gjyqësor, që ka analizuar themelin e çështjes, me vendim përfundimtar ka marrë përgjigje të arsyetuar për pretendimin e tij. Vendimet e dy gjykatave të zakonshme më të ulëta tregojnë mjaftueshëm rrethanat e çështjes, faktet e pranuar dhe përfundimet e nxjerra nga ato, si dhe dispozitat ligjore në të cilat ato janë bazuar për zgjidhjen e çështjes në atë mënyrë. Ato gjykata kanë vlerësuar provat dhe pretendimet e kërkuesit në lidhje me ligjin e zbatueshëm, porse në analizë të të gjitha provave të administruara në gjykim, si dhe ligjit të zbatueshëm, ato kanë arritur në përfundime jo të njëjta me të. Edhe vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i marrë në dhomën e këshillimit, tregon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, shkaqet e ngritura në rekurs, përmban një arsyetim të detajuar dhe të plotë për sa i përket zgjidhjes së mosmarrëveshjes të paraqitur përpara tij, ndërsa i ka dhënë përgjigje në thelb pretendimeve të kërkuesit për ligjin e zbatueshëm në rastin e tij. Ky vendim nuk duket që të përmbajë kontradikta, paqartësi ose pasaktësi të dukshme, duke respektuar kështu edhe elementet e trajtuara nga jurisprudenca kushtetuese për standardin e arsytimit të vendimeve gjyqësore. Përmes parashtrimit të shkaqeve të rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë tregon se, pasi i ka vlerësuar, ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur nga kërkuesit është haptazi i pabazuar, pasi shkaqet e ngritura në të nuk gjenin mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore.

21. Nga ana tjetër, për sa i përket pretendimit të kërkuesit, që në thelb ka të bëjë me interpretimin dhe zbatimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme, Kolegji vlerëson se ato nuk janë çështje që përfshihen në juridiksionin e Gjykatës, për sa kohë që nga kërkuesi nuk argumentohet se zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Vetëm fakti se në përfundim të procesit gjyqësor, në të cilin palët kanë pasur mundësinë të ushtrojnë garancitë e tyre procedurale, gjykatat kanë dhënë një vendim jo në favor të kërkuesit, nuk është i mjaftueshëm për të provuar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor.

22. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit është haptazi i pabazuar.

23. Për rrjedhojë, kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.